



## K762 Knauf Safeboard

Pllakë rrezembrojtëse

### E RE

■ Mbrojtje nga rrezet pa Plumb

# K762 Knauf Safeboard

Pllakë rrezembrojtëse



## Përshkrimi i produktit

Knauf Safeboard janë pllaka gipsi Tip DF sipas DIN EN 520 si dhe GKF (zjarrduruose) sipas DIN 18180 me karakteristikë shtesë të mbrojtjes nga rrezet. Për t'u dalluar, bërtama e gipsit është e ngjyrosur me të verdhë.

### Të dhëna për porosi

2500 mm gjatësi pllake: Art-Nr. 00132849  
Gjatësi të veçanta: Art-Nr. 00132850

## Fusha e përdorimit

Pllakat rreze-mbrojtëse përdoren në dhomat e radiografive të klinikave dentare dhe spitalore. Dhomat e radiografive kërkojnë një rrezembrojtje (mbështjellje) me dhomat fqinje. Sistemet rreze-mbrojtëse me Knauf Safeboard, gjejnë përdorimin e tyre në fushat e diagnostifikimit dhe terapisë me rreze, por që rrezatimi klasifikohet jo i lartë. Mbrojtja nga rrezet garantohehet në formën krijimit të elementëve ndërtimor mbështjellës të ambientit me vlera të njëjta specifike si të materialit rrezembrojtës plumbit.

## Karakteristikat

- Mbrojtje ekonomike nga rrezet
- pa plumb
- Peshë e vogël në krahasim me pllakat e veshura me shtresë plumbi
- Pllakë zjarrduruose
- Mbrojtja nga zjarri kombinohet me mbrojtjen nga rrezet edhe për tavane të varura
- Zë-izolim i mirë
- Liri krijimi arkitektonike falë teknikës së harkimit dhe palosjes
- Përpunim i thjeshtë dhe i sigurtë
- Depozitim dhe eliminim i thjeshtë i mbetjeve meqenëse pllaka nuk përmban plumb.

## Baza e materialit ndërtimor për mbrojtjen nga rrezet

Ambjentet e ekzaminimit me rreze kërkojnë një rrezembrojtje (mbështjellje) me ambientet fqinje. Rregullat për aplikimin e mbrojtjes nga rrezet janë të përcaktuara në DIN 6812:2002.

Baza e të gjithë masave për mbrojtjen nga rrezet është plani i mbrojtjes nga rrezet, që krijohet nga prodhuesi i paisjeve ekzaminuese me rreze-X.

Trashësia e shtresës së nevojshme mbrojtëse varet nga tensioni i tubit të pajisjes së vendosur (në varësi të ekzaminimit që do të kryhet) dhe është përcaktuar plumbi si material rreze-mbrojtës. Sa më i lartë të jetë tensioni aq më e madhe duhet të jetë trashësia e nevojshme e shtresës së plumbit.

Për shtresat izoluese prej materialesh të tjera ndikimi i mbrojtjes jepet i krahasuar me vlerën ekuivalente të plumbit. Vlera ekuivalente e plumbit e një materiali përcakton se cila trashësi plumbi në mm është e barabartë me vlerën mbrojtjes (mbështjellëse) nga rrezet. Të dhënat mbi vlerën ekuivalente të plumbit të materialeve të ndryshme ndërtimore gjenden në Tabelën 18 në DIN 6812. Elementët konstruktivë të rëndë prej betoni, të cilat përdoren për qëllime të mbrojtjes nga rrezet në spitale apo klinika mjekësore, sot mund të zëvendësohen thjesht, në mënyrë ekonomike dhe fleksibël nëpërmjet Sistemeve Knauf-Rrezembrojtëse.

Pllakat e gipsit me plumb që janë përdorur deri tani, për shkak të peshës së rëndë, kanë vështirësi në përpunim dhe kërkojnë një përkujdesje të lartë gjatë zbatimit për të krijuar një mbrojtje hermetike nga rrezet.


Për të minimizuar kostot ekstra për prodhimin e Sistemeve Rreze-mbrojtëse në krahasim me Sistemet e ndërtimit të thatë të mëparshme, u krijua pllaka e re Knauf Safeboard.

Kjo pllakë rrezembrojtëse mund të përpunohet si Sistem sëbashku me stukon Safeboard-Spachtel si çdo pllakë tjetër gipsi normale dhe ofron kështu të gjitha karakteristikat tekniko-ndërtimore (zëizolim, mbrojtje nga zjarri) si një pllakë normale gipsi.

Kështu plotësohen gjithashtu edhe kërkesat e mbrojtjes nga zjarri në tavanet e varura rrezembrojtëse.

## Të dhënat teknike

- Trashësi pllake: 12,5 mm
- Gjerësi pllake: 625 mm
- Gjatësi pllake: 2.500 mm
- Peshë e pllakës: 17 kg/m<sup>2</sup>
- Cepat: brinjët gjatësore me karton HRK  
brinjët ballore SK
- Tipi i pllakës sipas DIN EN 520 DF
- Tipi i pllakës sipas DIN 18180 GKF
- Rrezja minimale e harkimit  
harkim në të thatë:  $r \geq 2.750$  mm  
harkim në të njomë:  $r \geq 1.000$  mm



Numri pllakave	trashësi totale mm	Vlera ekuivalente e plumbit të pllakave rrezembrojtëse Knauf Safeboard (mm Pb)						
		60 kV	70 kV	80 kV	90 kV	100 kV	125 kV	150 kV
1	12,5	0,45	0,60	0,75	0,70	0,70	0,50	0,40
2	25	0,90	1,20	1,50	1,40	1,40	1,00	0,80
3	37,5	1,35	1,80	2,20	2,10	2,10	1,50	1,10
4	50	1,80	2,30	2,90	2,80	2,80	2,00	1,40
5	62,5					3,40	2,40	1,70
6	75					4,00	2,80	2,00

**Udhëzim:** Vlerat e ndërmjetme mund të interpolohen në mënyrë lineare. Të dhënat sipas DIN 6812

Për mamografi (35 kV) është e mjaftueshme vetëm një shtresë Safeboard.